



Në pajtim me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, si dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, të Ligjit Nr.04/L-155 për Sistemin e Pagesave, nenin 3, paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores për Raportimin e Institucioneve Financiare Jobankare, si dhe nenin 17, paragrafi 1, të Rregullores për Emetimin e Parasë Elektronike, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 nëntor 2020, miratoi këtë:

UDHËZIM PËR RAPORTIMIN E INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE ME PARA ELEKTRONIKE

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i formave të raportimit të institucioneve financiare jo-bankare (IFJB), të cilat janë të regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për ushtrimin e veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike.
2. Ky udhëzim zbatohet për IFJB-të (subjekte raportuese) të autorizuara nga BQK-ja për emetimin e parasë elektronike.

Neni 2 Periudha raportuese

1. Periudha për të cilën raportohet përfshin datat nga data 1 deri në datën e fundit të çdo muaji.
2. Raportimi bëhet përmes tabelave si në Shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi, sipas Tabelave nga 1 deri në 6, të cilat raportohen për çdo muaj, jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës.
3. Njësia ku raportohet është Divizioni i Mbikëqyrjes dhe Analizave të Sistemeve të Pagesave, Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Informacioni dërgohet në formë elektronike sipas formave të caktuar nga BQK-ja me anë të Shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi, në adresat e mëposhtme:

payment.systems@bqk-kos.org;

fina@bqk-kos.org.

Neni 3

Detyrimet për raportim

1. IFJB-të e autorizuar për emetimin e parasë elektronike raportojnë në përputhje me afatet dhe format e përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Ky udhëzim mund të rishikohet nga BQK-ja sa herë që konsiderohet e nevojshme, duke konsultuar dhe informuar IFJB-të përkatëse.
3. Raportimi përmban gjithsej gjashtë (6) tabela të përcaktuara në Shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi.

Neni 4

Pagesat sipas instrumenteve

1. Pagesat sipas instrumenteve raportohen sipas Tabelës nr. 1 në kuadër të Shtojcës 1 të këtij udhëzimi. Në këtë tabelë raportohen pagesat me para elektronike, të iniciuara nga mbajtësi i parasë elektronike (urdhëruesi) në favor të përfituesit. Këto pagesa raportohen të ndara sipas:
 - 1.1. pagesa me para elektronike nëpërmjet një karteje;
 - 1.2. pagesa me para elektronike të tjera.
2. Në tabelë duhet të plotësohet numri dhe vlera e pagesave, brenda ose jashtë vendit. Këtu përfshihen edhe transferet në të njëjtin emër por vetëm kur ato kryhen në llogari të institucioneve të parasë elektronike të ndryshme. Në këtë tabelë, për IFJB-të e parasë elektronike të cilat emetojnë para elektronike me kartela, përfshihen pagesa të kryera në terminale fizike (POS), si dhe në terminale virtuale (në internet, telefon mobil).
3. Në këtë tabelë nuk përfshihen transaksione në terminale për mbushjen dhe shkarkimin e parasë elektronike. Gjithashtu, për qëllime të këtij udhëzimi, në këtë tabelë, si dhe në tabelat në vijim, pagesat e anuluar ose të kthyera si rrjedhojë e mostërheqjes nga pranuesi brenda afateve të përcaktuara, nuk duhen raportuar si pagesa.
4. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutave në EUR, USD, CHF dhe valuta të tjera.

Neni 5

Transaksionet sipas tipit të terminaleve

1. Transaksionet sipas tipit të terminaleve raportohen sipas Tabelës nr. 2 në Shtojcën nr. 1 të këtij udhëzimi. Kjo tabelë përfshin raportimin në numër dhe vlerë të transaksioneve me para elektronike në lidhje me:
 - 1.1. Transaksione në terminale për mbushjen dhe shkarkimin e parasë elektronike. Këto transaksione mundësojnë transmetimin e vlerës së parasë elektronike nga lëshuesi të përdoruesi (mbajtësi) dhe anasjelltas. Lëshimi i parasë elektronike mund të bëhet nëpërmjet kartelave ose programeve dhe pajisjeve kompjuterike.
 - 1.2. Pagesa me para elektronike të cilat mund të bëhen nëpërmjet kartelave ose pajisjeve dhe programeve kompjuterike.

2. Llojet e transaksioneve të cilat raportohen në këtë tabelë, janë si më poshtë:
 - 2.1. Transaksione në терминаlet e instaluara nga institucioni raportues, me para elektronike të lëshuara nga institucioni raportues;
 - 2.2. Transaksione në терминаlet e instaluara nga institucioni raportues, me para elektronike të lëshuara nga institucione jashtë vendit;
 - 2.3. Transaksione në терминаlet e instaluara jashtë vendit, me para elektronike të lëshuara nga institucioni raportues; dhe,
 - 2.4. Transaksione në терминаlet e instaluara në vend nga institucione tjera, me para elektronike të lëshuara nga institucioni raportues.
3. Në këtë tabelë raportohen vetëm pagesat me kartela të kryera vetëm në terminale fizike (POS).
4. Në secilën nga rubrikat, pavarësisht valutës së vendit të origjinës të transaksionit, transaksionet raportohen në monedhën euro.

Neni 6

Kartelat e parasë elektronike

1. Kartelat e parasë elektronike raportohen sipas Tabelës nr. 3 në Shtojcën 1 të këtij udhëzimi. Kartela me funksion paranë elektronike nënkupton një kartelë që mundëson transaksione me para elektronike. Janë të përfshira kartelat në të cilat paraja elektronike mund të ruhet drejtpërdrejt dhe kartelat të cilat japin qasje në paranë elektronike të ruajtur në një llogari të parasë elektronike.
2. Kartela me funksion para elektronike - raportohet numri i kartelave të parapaguara të cilat mund të rimbushen dhe përdoren për një gamë të gjerë qëllimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë zë raportohen edhe kartelat me funksion para elektronike të cilat janë rimbushur të paktën një herë.
3. Në këtë tabelë raportohet gjithsej numri i kartelave të lëshuara nga institucioni raportues dhe të vlefshme/aktive në periudhën e raportimit. Këtu raportohet numri total i kartelave të lëshuara për klientët, pavarësisht sa shpesh ato janë përdorur gjatë periudhës së raportimit apo nëse përdoren brenda ose jashtë vendit. Kartelat të cilat kanë skaduar apo që nuk janë marrë në dorëzim nga klientët (joaktive), nuk përfshihen në këtë tabelë. Këtu përfshihen edhe kartelat e lëshuara nga institucioni në bashkëpunim me kompanitë, nëse ka të tilla.
4. Tabela 3 shoqërohet me informacionin mbi operatorin e kartelave të lëshuara nga raportuesi: kartela lokale (lëshuar nga vetë institucioni pa ndërmjetësimin e një operatori ndërkombëtar kartelash), Visa, MasterCard, apo të tjerë (operatorët e tjerë specifikohen nga vetë institucioni raportues).

Neni 7

Terminalet për paranë elektronike

1. Terminalet për paranë elektronike raportohen sipas Tabelës nr. 4 në shtojcën 1 të këtij udhëzimi. Në Tabelën 4, raportohet numri total i terminaleve në operim që janë në pronësi dhe/ose të instaluara nga institucioni raportues deri në fund të periudhës për të cilën raportohet. Këtu raportohen terminalet për përdorimin e parasë elektronike si me poshtë:
 - 1.1. *Terminalet për përdorimin e parasë elektronike* – raportohet numri total i terminaleve që lejojnë përdorimin e parasë elektronike. Këto terminale ndahen në:
 - 1.1.1. terminale për rimbushjen apo shkarkimin e tyre. Këto terminale lejojnë transferimin e fondeve elektronike nga lëshuesi tek përdoruesi.
 - 1.1.2. terminale për kryerjen e pagesave me para elektronike. Terminalet në pikat e shitjes (ang.: point of sale POS) të cilat lejojnë transferimin e parasë elektronike nga kartela tek tregtari ose tek llogaria e tregtarit ose çdo përfitues tjetër.

Neni 8

Numri i llogarive të parave elektronike

1. Numri i llogarive të parave elektronike raportohet sipas Tabelës 5 në Shtojcën 1 të këtij udhëzimi. Në këtë tabelë raportohet numri i llogarive të klientëve në funksion të përdorimit të parasë elektronike. Llogaritë e klientëve në funksion të parasë elektronike raportohen të ndara sipas valutës së llogarisë në EUR, USD CHF apo valuta të tjera.
2. Llogaritë e parasë elektronike – janë llogaritë në të cilat paraja elektronike ruhet. Bilanci në llogari mund të përdoret nga mbajtësi i llogarisë për të kryer pagesa dhe të transferojë mjete mes llogarive. Kartelat në të cilat paraja elektronike mund të vendoset drejtpërdrejt nuk raportohen në këtë kategori.

Neni 9

Vlera në përdorim e parasë elektronike

1. Vlera në përdorim (ang.: outstanding) e parasë elektronike raportohet sipas Tabelës 6 në Shtojcën nr. 1. Në këtë tabelë raportohet vlera në përdorim (outstanding) e parasë elektronike të lëshuar nga institucioni raportues dhe e ruajtur në kartela, kompjuterë personale, serverë ose telefona mobilë.
2. Vlera në përdorim (outstanding) e parasë elektronike ndahet në:
 - 2.1. Vlerën në përdorim (outstanding) të parasë elektronike të ruajtur në kartela (ang.: card-based);
 - 2.2. Vlerën në përdorim (outstanding) të parasë elektronike të bazuar në sisteme kompjuterike (ang.: computer-based) - ku përfshihen:
 - 2.2.1. Të bazuara në softuer (ang.: software-based): raportohet vlera në përdorim (outstanding) e parasë elektronike e ruajtur në produkte të cilat bazohen në

programe të instaluara në kompjuterë personale dhe të cilat mundësojnë transferimin e vlerave elektronike nëpërmjet rrjeteve të telekomunikacionit si për shembull interneti.

2.2.2. Të bazuara në rrjet (ang.: network-based): raportohet vlera në përdorim (outstanding) e parasë elektronike, me produkte të cilat ruajnë vlerën monetare në një server qendror. Kjo vlerë monetare përdoret për blerje në internet.

2.2.3. Të bazuara në telefon (ang.: mobile-based): raportohet vlera në përdorim (outstanding) e parasë elektronike ku vlera monetare e parasë ruhet në telefona mobilë.

3. Vlera në përdorim (outstanding) e parasë elektronike do të raportohet si mesatare mujore.

Neni 10

Masat përmirësuese dhe dënimet civile

Shkeljet e këtij udhëzimi do të jenë subjekt i masave dhe ndëshkimeve ashtu siç parashihet me Rregulloren për Regjistrimin e Institucioneve Financiare Jobankare, Rregulloren për Emetimin e Parasë Elektronike dhe Rregulloren për Raportimin e Institucioneve Financiare Jobankare.

Neni 11

Shtojcat

Ky udhëzim përmban Shtojcën nr. 1 me format e raportimit të IFJB-ve të përcaktuara sipas Tabelave 1- 6.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi nga data 1 dhjetor 2020.

Fehmi Mehmeti

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

Udhëzimi u dërgohet / komunikohet:

- Departamentit të Sistemeve të Pagesave (DSP) dhe Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë (DMJ)
- Institucioneve për të cilat është i aplikueshëm (t'u dërgohet udhëzimi në mënyrë elektronike nga DSP)
- Publikut të gjerë (të publikohet udhëzimi në faqen e internetit të BQK-së nga DMJ)

Shtojca 1 – Formularët e Raportimit (1/3)

a) Informata për institucionin dhe periudhën raportuese.



Emri i IFJB-së

Raportimi për periudhën:

/

muaji

viti

Përgatitur nga:

emër, mbiemër, nr telefoni

Verifikuar nga Drejtori/Udhëheqësi:

emër, mbiemër, nr telefoni

Datë

Shtojca 1 – Formularët e Raportimit (2/3)

b) Tabela 1. Pagesat sipas instrumenteve

Rubrika	Përshkrimi i pagesës sipas instrumentit të pagesës	Pagesa në EUR		Pagesa në USD		Pagesa në CHF		Pagesa në valuta të tjera	
		Numri	Vlera	Numri	Vlera	Numri	Vlera	Numri	Vlera
I.	Pagesa me para elektronike (1+2)	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>								
	1- pagesa me para elektronike nëpërmjet një kartele	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	2- pagesa me para elektronike tjera	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

c) Tabela 2. Transaksionet sipas tipit të terminaleve

Rubrika	Përshkrimi	Transaksionet	
		Numër	Vlera (€)
I	Transaksione në терминаlet e instaluar nga institucioni raportues, me para elektronike të lëshuara nga institucioni raportues		
	1-Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqjen e vlerës së mbetur të parasë elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		
	2-Pagesa me para elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		
II	Transaksione në терминаlet e instaluar nga institucioni raportues, me para elektronike të lëshuara nga institucione jashtë vendit		
	1-Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqje e vlerës së mbetur të parasë elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		
	2-Pagesa me para elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		
III	Transaksione në терминаlet e instaluar jashtë vendit, me para elektronike të lëshuara nga institucioni raportues		
	1-Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqje e vlerës së mbetur të parasë elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		
	2-Pagesa me para elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		
IV	Transaksione në терминаlet e instaluar në vend nga institucione tjera, me para elektronike të lëshuara nga institucioni raportues		
	1-Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqje e vlerës së mbetur të parasë elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		
	2-Pagesa me para elektronike	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a-me kartela		
	b-me software		

Shtojca 1 – Formularët e Raportimit (3/3)

d) Tabela 3. Kartelat e parasë elektronike

Rubrika	Numri i kartelave sipas funksioneve/operatorëve	Kartela lokale	VISA	MasterCard	Tjera	Gjithsej
I.	Kartela me funksion para elektronike <i>prej të cilave:</i> - Kartela me funksion para elektronike me rimbushje të paktën një herë					

e) Tabela 4. Terminalët për paranë elektronike

I.	Terminalë për përdorimin e parasë elektronike (1+2)	0.00
	<i>prej të cilave:</i>	
	1-terminalë për rimbushjen apo shkarkimin e parasë elektronike	0.00
	2-terminalë për kryerjen e pagesave me para elektronike	0.00

f) Tabela 5. Numri i llogarive të parave elektronike

Rubrika	Përshkrimi	EUR	USD	CHF	Tjera	Gjithsej
I.	Numri i llogarive të parasë elektronike					

g) Tabela 6. Vlera outstanding e parave elektronike

Rubrika	Përshkrimi	Euro	Në valuta të tjera
I	Vlera outstanding e parasë elektronike e ruajtur në produktete (1+2)	0.00	0.00
	1. Card- based	0.00	0.00
	2. Computer- based	0.00	0.00
	<i>nga të cilat:</i>		
	a) software- based	0.00	0.00
	b) network-based	0.00	0.00
	c) mobile-based	0.00	0.00